



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 744/14 Prot.

Tiranë, më 3/8/2016

V E N D I M

Nr. 52, datë 3/8/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Amarildo Belshi" Person Fizik (Klinika e Syrit), Tiranë.

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 173, datë 19.07.2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Amarildo Belshi" P. F (Klinika e Syrit), nipt K81702040K, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga ana e personit me iniciale O.SH. në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
- Plotësimi i detyrimit për njoftim, (nenet 21 dhe 22) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;

Kontrolluesi "Amarildo Belshi" P. F (Klinika e Syrit), ushtron aktivitetin si klinikë mjekësore e syrit. Gjatë veprimtarisë së tij kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna për kategoritë e subjekteve "Pacientë" dhe "Punëmarrës". Për kategorinë "Pacientë" nëpërmjet "Kartelës së Pacientit", kontrolluesi përpunon të dhënat personale (emër/mbiemër, mosha, adresa nr. telefonit), profesioni, personi shoqëruar si dhe të dhëna mbi sëmundjet e pacientit.

Për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Punëmarrës", kontrolluesi përpunon të dhëna personale: të identifikimit, numrin e sigurimit shoqëror, numrin personal të identifikimit, të dhënat e kartës së identitetit dhe të librezës së punës, nëpërmjet administrimit të dokumenteve në dosjen e punës, për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe në zbatim të detyrimeve ligjore (Kodi i Punës).

1. Në kuadër të trajtimit të ankesës (objekti i parë i Urdhrit), është konstatuar se kontrolluesi kishte vendosur në ambientet e brendshme kamera vëzhgim regjistrimi CCTV. Nëpërmjet sistemit të video-surveimit kontrolluesi përpunonte të dhënat personale imazhe dhe video të subjekteve të të dhënave punonjës dhe klientë. Kontrolluesi kishte në administrim 8 kamera të cilat janë të vendosura në hyrje dhe brenda ambientit ku ushtron aktivitetin. Këto të dhëna i ruan për një afat 20 ditor me qëllim garantimin e sigurisë dhe aksesohen vetëm nga administratori.

Kontrolluesi nuk kishte realizuar informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave të surveimit në hyrje të ambienteve, ku ushtron veprimtarinë e tij, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe me Udhëzimin e Komisionerit nr. 3, datë 05/03/2010 “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit konstatoi se kartela e pacientit e cila firmoset nga pacienti ose personi shoqëruar, nuk përmban informacion për subjektet e të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Gjithashtu, në faqen e internetit të kontrolluesit (*amarildobelshi.com*) nuk është i parashikuar informimi nëpërmjet rubrikës “Politikat e privatësisë”, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë “Politikat e privatësisë”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet. Në këtë kuadër, publikimi i “Politikave të privatësisë” përmbush më së miri qëllimin e informimit.

Në frymën e ligjit, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht mënyrës së mbledhjes së të dhënave, ka detyrimin që të informojë çdo subjekt të dhënash mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

2. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi nuk kishte hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës dhe përcakton standardet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).

Megjithatë, Zyra e Komisionerit vlerëson faktin që kontrolluesi reagoi në mënyrë të menjëhershme, në drejtim të hartimit dhe të plotësimit të këtij detyrimi duke përgatitur një projekt-rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, të cilën e ka paraqitur për mendim pranë grupit të hetimit administrativ.

3. Në lidhje me objektin e dytë të Urdhrit, nga verifikimi paraprak i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se kontrolluesi nuk e kishte përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar.

Në paragrafin 1, të nenit 21 të ligjit, parashikohet: *“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, në datë 29/07/2016 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore deklaroi se: *“Jemi dakord me të gjitha shkeljet e gjetura nga inspektorët, moszbatimi i ligjit ka ardhur si pasojë e mosnjohjes së tij nga ana jonë megjithatë menjëherë kemi përgatitur një projekt-rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, të cilën e kemi paraqitur për mendim pranë grupit të hetimit administrativ dhe po e përfundojmë sipas sugjerimit të tyre. Do të zbatojmë detyrimin për njoftim dhe do të vendosim tabelën informuese për CCTV sipas standardit të miratuar me Udhëzimin e Komisionerit. Gjithashtu po marrim masa për të përgatitur informacionin që do i bashkëngjitet kartelës së pacientit.*

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronjat *“b”* dhe *“d”*, të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

**b)** kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

**d)** Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 500 000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me të drejtën e subjekteve të të dhënave për tu informuar mbi përpunimin e të dhënave dhe masat e sigurisë në zbatim të ligjit. Gjithashtu, bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ si dhe reagimin e kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

### PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 21, 29, 30, 31, 39/1/b dhe 39/1/d, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Amarildo Belshi" P. F (Klinika e Syrit) me gjobë, në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Amarildo Belshi" P. F (Klinika e Syrit) me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 3 . 8 /2016.

  
Besnik DERVISHI  
KOMISIONERI